



PROPOZIM

Në mbështetje të nenit 34, paragrafi (4) dhe nenit 47, paragrafi (1), pika 10-a) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21 dhe 74/24), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për Metodologjinë e llogaritjes së shumës së tarifës vjetore për realizimin e mbikëqyrjes ndaj bankave dhe kursimoreve, si dhe për mënyrën e faturimit të saj

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

1. Me këtë vendim përshkruhet metodologjia e llogaritjes së shumës së tarifës vjetore për realizimin e mbikëqyrjes ndaj bankave dhe kursimoreve, në pajtim me ligjin nga Banka Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëposhtëm: Banka Popullore), si dhe mënyrën e faturimit të saj.

II. PËRKUFIZIMET

2. Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë vendim, kanë këtë kuptim:

2.1. "Tarifa vjetore" është shuma që e paguan çdo bankë ose kursimore për realizimin e mbikëqyrjes nga Banka Popullore, në pajtim me ligjin për vitin vijues kalendarik, në mënyrën e përcaktuar në kreun IV të këtij vendimi;

2.2. "Shpenzimet direkte" janë shpenzimet e njësive organizative të Bankës Popullore që janë drejtpërdrejt përgjegjëse për mbikëqyrjen e bankave dhe kursimoreve;

2.3. "Shpenzimet indirekte" janë shpenzimet e Bankës Popullore të cilat në mënyrë të tërthortë lidhen me mbikëqyrjen e bankave dhe të kursimoreve, respektivisht shpenzimet e njësive organizative që ofrojnë mbështetje administrative dhe tjetër për njësitë organizative të Bankës Popullore, të cilat janë drejtpërdrejt përgjegjëse për mbikëqyrjen e bankave dhe kursimoreve.

III. METODOLOGJIA E LLOGARITJES SË TARIFAVE VJETOR

3. Baza e llogaritjes së tarifës vjetore është shuma e shpenzimeve direkte dhe pjesa korresponduese e shpenzimeve indirekte të kryera për mbikëqyrjen e bankave dhe kursimoreve në një vit kalendarik.

4. Pjesa korresponduese e shpenzimeve indirekte përcaktohet në bazë të vëllimit të shërbimeve të cilat njësitë organizative, operimi i të cilave lidhet drejtpërdrejt me kryerjen e mbikëqyrjes e marrin nga njësitë organizative që ofrojnë mbështetje administrative dhe mbështetje tjetër.

5. Tarifa vjetore për një bankë individuale ose kursimore që paraqet mbledhje të shumës e cila fitohet si më poshtë:

- 50% nga baza e llogaritjes u shpërndahet bankave të veçanta ose kursimoreve, në përqindje të barabartë me përqindjen e pjesës së aktiveve të bankës së veçantë ose kursimoreve, në totalin e aktiveve të të gjitha bankave dhe kursimoreve në fund të vitit kalendarik paraardhës;

- 50% nga baza e llogaritjes u shpërndahet bankave të veçanta ose kursimoreve, në përqindje të barabartë me përqindja e pjesës së aktiveve të ponderuara sipas rreziqeve për çdo bankë ose kursimore në totalin e aktiveve të ponderuara, me rrezik për të gjitha bankat dhe kursimoret në fund të vitit kalendarik paraardhës.

Për qëllime të paragrafit (1) të kësaj pike, Banka Popullore i përdor të dhënat e mëposhtme:

- për aktivën e ponderuara sipas rreziqeve përdoren të dhënat që bankat dhe kursimoret ia dorëzojnë Bankës Popullore, në pajtim me rregulloren e Bankës Popullore për Metodologjinë e përcaktimit të mjaftueshmërisë së kapitalit,

- për shumën e totalit të aktivës përdoren të dhënat nga raporti financiar i bankës ose i kursimores për vitin e kaluar kalendarik, të audituar nga shoqëri auditimi në pajtim me ligjin.

6. Me përjashtim të pikës 5) të këtij vendimi, në rast se një bankë ose kursimore ka marrë licencë për themelim dhe operimi gjatë vitit të kaluar kalendarik, shuma e tarifës vjetore për bankën ose kursimoren, përcaktohet kur shuma e përcaktuar në pajtim me pikën 5) nga ky vendim do të ndahet në dymbëdhjetë muaj dhe do të shumëzohet me numrin e muajve në të cilët banka ose kursimorja ka operuar në vitin e kaluar kalendarik.

7. Në rast se Banka Popullore pushon së realizuari mbikëqyrje ndaj një banke ose kursimore, për shkak të anëtarësimit në një bankë tjetër dhe/ose kursimore gjatë vitit të kaluar kalendarik, tarifa që i detyrohet bankës ose kursimores që anëtarësohet, ngarkohet nga banka ose kursimorja që anëtarësohet.

8. Banka Popullore e përcakton shumën e tarifës vjetore për çdo bankë dhe kursimore në pajtim me këtë vendim, për vitin vijues kalendarik jo më vonë se 31 maji, bazuar në të dhënat e 31 dhjetorit të vitit të kaluar kalendarik.

9. Banka Popullore, në faqen e saj të internetit, jo më vonë se 31 maji i vitit vijues, i publikon të dhënat mbi bazën e llogaritjes së tarifës vjetore dhe për shumën totale të aktiveve dhe aktiveve të ponderuara sipas rrezikut, kolektivisht, të të gjitha bankave dhe kursimoreve.

IV. MËNYRA E PAGESËS

10. Banka Popullore ia dërgon bankës ose kursimores njoftimin për tarifën vjetore, në afat prej pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e përcaktimit të shumës së tij.

Mënyra e pagesës përcaktohet në njoftimin për tarifim nga paragrafi (1) i kësaj pike.

Banka ose kursimorja është e detyruar ta paguajë tarifën vjetore brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e marrjes së njoftimit nga paragrafi (1) i kësaj pike.

Nëse banka ose kursimorja nuk e paguan tarifën brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (3) të kësaj pike, Banka Popullore përlogarit dhe normë gjobë ligjore të interesit për vonesë të pagesës.

V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

11. Banka Popullore do ta përcaktojë tarifën e parë vjetore, për çdo bankë dhe kursimore në pajtim me këtë vendim në vitin 2025.

12. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Nr. 02-34557/3

9.10.2024

Shkup

Veriut

Guvernatorja

dhe kryesuesja

**e Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë së**

д-р Анита Ангеловска-Бежоска